

VENDIM
Nr.105, datë 18.2.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.148, DATË 31.3.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MËNYRËN E SHITJES SË MALLRAVE, TË ARDHURA GRANT NGA
JAPONIA, NË KUADËR TË PROJEKTIT “SHTIMI I PRODHIMEVE USHQIMORE”, 2KR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 2 të vendimit nr.148, datë 31.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të marrë përsipër shërbimin teknik të mjeteve të mekanikës bujqësore, që do të shiten me këste, për të gjithë periudhën deri në shlyerjen përfundimtare të tyre nga përdoruesit. Ky shërbim të realizohet sipas procedurave ligjore, nëpërmjet kontraktimit me subjektet, që kryejnë këto shërbime, të përzgjedhura me tender të hapur. Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit teknik të përdoret fondi kundërparti, në masën 10 për qind, i arkëtuar nga përfituesit e traktorëve 50 KF e të makinerive bujqësore, dhe në masën 5 për qind, i arkëtuar nga përfituesit e traktorëve mbi 50 KF dhe të kombajnave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano